



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:140562

Datë: 13.11.2020

Numri i dokumentit: 01270106

PKR.nr.1027/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE – DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA NË PRISHTINË, në përbërje nga kryetarja e trupit gjykues - gjyqtarja Shpresa Hasaj -Hyseni, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Egzona Shala, në çështjen penale kundër të akuzuarit F. K., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.2, të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë së Shtetit në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.I.Nr.391/20, të datës. 06.11.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestarë, në prani të akuzuarit F.K. dhe prokurorit të shtetit Bashkim Zeqaj, me dt.10.11.2020, publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

F.K., i biri i Xh., dhe nënës R., e gjinisë M., i lindur me dt....., në P., me vendbanim në rrugën Mahalla e ‘’....’’ fsh.G. K-P., me nr. personal:, i martuar, baba i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, tani i papunë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

Sepse: Më datë.20.08.2020, rreth orës 15:05min, në fshatin G. Komuna e P., gjatë kontrollit nga ana e policisë të shtëpisë dhe objekteve përcjellëse, pronë e të pandehurit F. K., sipas urdhëresës për kontroll , janë gjetur: një pushkë gjysmë automatike, me numër serik 653730, një pushkë ajrore me numër serik RYS191100029, tre karikatorë, 40 fishek të kalibrit 7.62, 16 fishek të pushkës gjysmë automatike, 250 fishek të AK-47, 195 fishek me dritë të AK-47, 14 fishek të shkurtër të kalibrit 9mm, 8 fishek të gjatë të kalibrit 9mm, 13 fishek të pushkës së gjuetisë, bateri ndriçuese, dy çanta të vogla për bartjen e fishekëve dhe një fotrollë e pistoletës, të cilat armë i pandehuri i ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim, pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët nr. 05/L-022, të cilat i janë sekuestruar,

-me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.2, të KPRK-së,

Prandaj, gjykata konform dispozitave 2, 4,7, 41,46,51,52, 73,62,69,75,76, dhe 374 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 365, 366, 450 par .2 pika 2.6, të KPP-së, e:

G J Y K O N

Të akuzuarit F. K., i përcakton Dënim me Gjobë, në shumën prej 1.000 (njëmijë) €, të cilin dënim është i obliguar ta përmbushë me 4 këste, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk e përmbushë dënimin me gjobë, atëherë i njëjti dënim, do të ju zëvendësohet me dënim Burgimi, ashtu që një natë burgim vlen 20 €.

Ndaj të njëjtit, shqiptohet **dënimi plotësues-** konfiskohen armët e zjarrit; pushkë gjysmë automatike, me numër serik 653730, një pushkë ajrore me numër serik RYS191100029, tre karikatorë, 40 fishek të kalibrit 7.62, 16 fishek të pushkës gjysmëautomatike, 250 fishek të AK-47, 195 fishek me dritë të AK-47, 14 fishek të shkurtër të kalibrit 9mm, 8 fishek të gjatë të kalibrit 9mm, 13 fishek të pushkës së gjuetisë, bateri ndriçuese, dy çanta të vogla për bartjen e fishekëve dhe një fotrollë e pistoletës si mjete të kryerjes se veprës penale.

Obligohet i akuzuari, që t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës sipas llogarisë së kësaj gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor, të paguaj shumën prej **30 (tridhjetë) €**, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbartimit.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë- DKR, ka ngritur aktakuzën PP.I.Nr.391/20, të datës. 06.11.2020, kundër të akuzuarit F.K., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.2, të KPRK-së. Këtë lëndë gjyqtarja e çështjes, e ka pranuar me dt. 09.11.2020.

Lidhur me këtë çështje penalo-juridike, është caktuar dhe mbajtur shqyrtimi fillestar me dt.10.11.2020, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i akuzuari ka deklaruar se ka kuptuar aktakuzën me të cilën akuzohet dhe nuk ka nevojë për sqarime shtesë, dhe sipas nenit 246 të KPPK-së, pasi që i është dhënë mundësia të deklarohet lidhur me aktakuzën, në kuptim të nenit 248 të KPP-së, i akuzuari ka deklaruar;se pranon fajësinë, pendohem për këto armë që më janë gjetur, këto armë i kam gjetur në mal, se i vjen keq për veprimet e tij, se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, dhe hera e parë që gjendet në gjykatë dhe i premtos gjykatës se nuk do të përsëris më kurrë kurrfarë vepre penale.

Për pranimin e fajësisë nga i akuzuari, kryetarja e trupit gjykues mori edhe mendimin e prokurorit të shtetit, i cili gjithashtu deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i akuzuari, ngase pranimi i fajësisë është bërë mbi bazën e provave dhe fakteve, duke konsideruar se provat materiale të bashkëngjitura aktit akuzues, vërtetojnë mjaftueshëm kryerjen e veprës penale nga i akuzuari, i propozoi gjykatës që të akuzuarin t'a shpallë fajtor dhe t'a dënoj sipas ligjit, ndërsa me rastin e matjes së dënimin nga gjykata si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë nga i akuzuari.

Gjykata aprovoi pranimin e fajësisë pasi që konsideron se ky pranim bëhet vullnetarisht, pa presion, pas njoftimit lidhur me beneficionet dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit

mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe është në përputhje me dispozitat ligjore të KPP-së.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që lidhur me të akuzuarin gjykata ia mori parasysh si rrethana posaqërisht lehtësuese në kuptim të nenit 75 dhe 76 të Kp-ës; faktin se e ka pranuar fajësinë dhe ka shpreh keqardhje për atë që ka ndodhë, ka qenë herë e parë që ka ra ndesh me ligjin, premtimin se nuk do të përsëris veprën penale.

Ndërsa si rrethanë rënduese, gjykata pati parasysh rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale.

Gjykata konsideron se dënimi i shqiptuar është në proporcion me nenin 41 të KP-së, se qëllimi i dënimit do të arrihet edhe me dënimin e shqiptuar si me lart. Duke pasur parasysh se dënimi ka karakter preventive dhe edukues, e jo qëllim represiv apo ndëshkues, që edhe i akuzuari por edhe të tjerët në të ardhmen të mos kryejnë kurrfarë vepra penale.

-Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 të KPPK-së

-Vendimi mbi dënimin plotësues është marrë konform neneve 62 par. 1 dhe 2 pika 2.6, nenit 69 të KPRK-së.

Më sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.1027/20, me dt.10.11.2020

Sekretare juridike:
Egzona Shala

Kryetarja e Trupit gjyqësor-gjyqtarja
Shpresa Hasaj-Hyseni

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, brenda 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2020:140562
Datë: 13.11.2020
Numri i dokumentit: 01270106